




COLLOQUE INTERNATIONAL



RAYONNEMENT FRANCOPHONE ET
VALORISATION DE L'ALBANIE :
TRADITION, MODERNITÉ ET PONTS CULTURELS



05.12. 2024



FGJH-UT





UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

Thirrje për pjesëmarrje

Konferencë Ndërkombëtare

”Frankofonia dhe promovimi i Shqipërisë: tradita, moderniteti dhe urat kulturore”

5 dhjetor 2024

Me rastin e 30 vjetorit të Agjencisë Universitare të Frankofonisë në Evropën Qendrore dhe Lindore, Departamenti i Gjuhës Frënge i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në partneritet me AUF ECO , Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Frënge i Universitetit “Hasan Prishtina” të Prishtinës, Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Frënge të Shqipërisë (APFA) dhe Ambasada Franceze në Shqipëri, organizojnë konferencën “ *Frankofonia dhe promovimi i Shqipërisë: tradita, moderniteti dhe urat kulturore* ”.

Kjo konferencë synon të nxjerrë në pah rolin thelbësor të botës frankofone në promovimin e imazhit të Shqipërisë, një vend ku tradita dhe moderniteti shkrihen në mënyrë harmonike. Duke eksploruar dimensionet e ndryshme të kulturës shqiptare – trashëgiminë e saj historike, artistike dhe gjuhësore – theksi vihet në lidhjet e saj të thella me botën frankofone. Gjuha frënge shihet këtu si një urë e vërtetë kulturore, që lehtëson shkëmbimet mes Shqipërisë dhe vendeve frëngjishtfolëse. Analiza do të fokusohet gjithashtu në nismat që synojnë promovimin e kulturës dhe gjuhës shqipe

në këto vende, si dhe mundësitë që ofron Frankofonia për të forcuar marrëdhëniet diplomatike, ekonomike dhe kulturore midis Shqipërisë dhe vendeve frankofone. Së fundi, do të diskutohen sfidat dhe mundësitë për promovimin e Frankofonisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me fokus veprimet konkrete që do të ndërmerren për të thelluar këtë marrëdhënie të privilegjuar, për të promovuar mirëkuptim dhe respekt të ndërsjellë për diversitetin kulturor.

Boshtet rreth të cilave do të përqëndrohen tema e konferencës do të jenë si më poshtë:

1. Frankofonia dhe diplomacia kulturore: një vektor ndikimi për Shqipërinë

- Roli i Frankofonisë në ndërtimin e një imazhi modern të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare.
- Analizë e partneriteteve diplomatike dhe shkëmbimeve kulturore midis Shqipërisë dhe vendeve Frankofone.

2. Gjuha frënge si një portë për shkëmbimin kulturor dhe artistik

- Ndikimi i botës frëngjishtfolëse në skenën artistike shqiptare (letërsi, përkthim, kinema, muzikë etj.).
- Shembuj të artistëve shqiptarë frankofonë që kanë kontribuar në përhapjen e kulturës shqiptare jashtë vendit.

3. Trashëgimia historike dhe gjuhësore e Shqipërisë në prizmin e botës frëngjishtfolëse

- Eksplorimi i ndërveprimeve historike midis Shqipërisë dhe vendeve frëngjishtfolëse.
- Studimi i gjuhës frënge në Shqipëri: një mjet për hapjen dhe transmetimin kulturor.

4. Frankofonia dhe promovimi ekonomik: mundësi për Shqipërinë

- Roli i shkëmbimeve ekonomike të lehtësuara nga Frankofonia në zhvillimin e imazhit dhe atraktivitetit të Shqipërisë.
- Mundësitë e biznesit që ofron Frankofonia për sektorin e turizmit dhe sipërmarrjes në Shqipëri.

5. Çështjet dhe sfidat bashkëkohore të Frankofonisë në hapësirën shqipfolëse

- Pengesat që duhen kapërcyer për të forcuar lidhjet me vendet frëngjishtfolëse (arsim, komunikim).
- Veprime konkrete që mund të merren për të përhapur më shumë Frankofoninë në Ballkanin Perëndimor.

6. Promovimi i diversitetit kulturor: Frankofonia si një urë për mirëkuptimin e ndërsjellë

- Promovimi i diversitetit kulturor shqiptar brenda botës frëngjishtfolëse.
- Strategji për rritjen e ndërgjegjësimit dhe respektimin e identiteteve kulturore në kontekstin e shkëmbimeve frëngjishtfolëse.

MBI DORËZIMIN E KUMTESAVE :

Ftojme të gjithë të interesuarit të paraqesin një propozim kumtese i cili do t'i dërgohet komitetit shkencor për një proces vlerësimi. Propozimi i kumtesës mund të jetë në frëngjisht, anglisht ose shqip dhe të përfshijë një titull, një përmbledhje prej afërsisht 500 fjalësh, një shënim biografik (300 fjalë), boshtin në të cilin merr pjesë, 3 deri në 5 fjalë kyçe, 5 referenca bibliografike. Propozimet duhet të dërgohen në adresën e emailit colloquetirana2024@gmail.com ose online ne linkun e mëposhtem : <https://forms.gle/3EYgqHoa6qmRgpLd7>

AFATI

Afati i fundit për dërgimin e propozimeve : 9 nëntor 2024

Afati i fundit për njoftimin e përgjigjeve, pas vlerësimit: 18 nëntor 2024

Shfaqja e programit të konferencës: 25 nëntor 2024

Data e konferencës: 5 dhjetor 2024

Vendi i konferencës : Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë, Shqipëri

Gjuhët e punës së konferencës : frëngjisht, anglisht, shqip.

Prezantimi : 15 minuta dhe 5 minuta diskutim

Programi dhe certifikatat : Programi i detajuar dhe certifikatat e pjesëmarrjes për konferencën do t'u shpërndahen pjesëmarrësve.

Publikimi i punimeve : komunikimet do t'i dorëzohen komitetit të vlerësimit me qëllim publikimin e akteve të konferencës.

Komiteti Shkencor :

- Prof. Dr. Esmeralda Kromidha, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Saverina Pasho, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Andromaqi Haloçi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Eldina Nasufi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Raul Lilo, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Persida Asllani, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Laure Castin, Agjencia Universitare e Frankofonisë në Evropën Qendrore dhe Lindore,
- Prof. Dr. Silvana Vishkurti, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Lindita Gjata, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Dr. Valbona Berisha Gashi, Fakulteti Filologjik, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë
- Prof. Dr. Nerimane Kamberi, Fakulteti Filologjik, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë,
- Prof. Dr. Bade Bajrami, Fakulteti Filologjik, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë,
- Z. Luan Rama, Shkrimtar, Ish Ambasador i Shqipërisë në Francë
- Prof. Asoc. Dr. Alba Frashëri, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Ardiana Kastrati Hyso, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Lorena Dedja, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Fioralba Dado, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Migena Alimehmeti, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Eglantina Gishti, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës , Shqipëri

- Dr. Anna Markova, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, St. Kliment Ohridski” nga Sofja, Bullgari
- Dr. Jeanna Kristeva, Fakulteti i Letërsisë Klasike dhe Moderne në Universitetin “St. Kliment Ohridski” nga Sofja, Bullgari
- Prof. Asoc. Dr. Mariana Soeva, Universiteti “Stefan cel Mare” në Suceava, Rumani
- Prof. Asoc. Dr. Loubna Nadim Nadim, Departamenti i Filologjisë Franceze, Universiteti i Granadës, Spanjë
- Prof. Asoc. Dr. Benita Stavre - Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Angjelina Neshati Shllaku, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri
- Prof. Asoc. Dr. Dhurata Hoxha, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri Dr.
- Prof. Asoc. Dr. Drita Brahimi, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, Shqipëri
- Dr. Drita Rira, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Laureta Mema, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Bora Kuçuku, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës, Shqipëri
- Dr. Lendita Gjokolli, Fakulteti Filologjik, Universiteti “Hasan Prishtina”, Prishtinë, Kosovë